

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "GB THERMO- COLOR" SHPK

Sot, në Tiranë, më **01/05/2018**, unë **Gëzim Xhevdet Salliu**, hartoj Aktin e Themelimit me një themelues të vetëm të shoqërisë "**GB Thermo - Color**" **Shpk.** sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijojnë:

Neni 1 Themelimi

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është "**GB Thermo - Color**" **Shpk.** (këtu më poshtë e quajtur "**Shoqëria**"). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me pergjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

Neni 2 Selia

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Tiranë, Njësia Administrative nr.5, Rruga "Bajram Curri " Hyrja nr.1, Zona Kadastrale nr.8260, Nr.Pasurisë 1/362-N6, volume 32, Faqe 180.**
- 2) Shoqëria mund të themeloje degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3 Objekti

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- 1) Tregëtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndryshme të ndërtimit si dhe mallrave industrialë të të gjitha llojeve .

Tiranë, Njësia Administrative nr.5, Rruga "Bajram Curri " Hyrja nr.1, Zona Kadastrale nr.8260, Nr.Pasurisë 1/362-N6, volume 32, Faqe 180;

Email: info@gbthermocolor.al

- 2) Import dhe Eksport i mallrave industrialë dhe materialeve të ndërtimit.
- 3) Shërbime në ndërtim (termoizolim fasade, shtrim pllakash, suvatime të brendshme e të jashtme, lysterje me boje, instalime elektrike dhe hidraulike) etj .
- 4) Shërbime pastrimi të të gjitha llojeve.
- 5) Administrim pallatesh.

Shoqëria mund të zhvillojë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër të afërt ose që lidhet me objektin e saj, e vetme ose me pjesëmarrje me ente, ndërmarrje apo shoqëri të tjera, duke kryer të gjitha operacionet financiare të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë.

Neni 4 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5 **Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm**

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1 (një) pjesë me vlerë nominale të një pjesë prej 100.000,00 (njëqindmijë) lekësh.
- 2) Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është **Z.Gëzim Salliu** , atësia **Xhevdet**, i dtl. **04/04/1981** lindur në **Gjocaj, Elbasan** dhe banues në **Tiranë** , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me **nr. 030240112**.

Neni 6 **Ortaku i Vetëm**

Ortaku i vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Neni 7 **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratoria, **Znj. Brunilda Seneja**, atësia **Njazi**, e datëlindjes **30/05/1989** lindur në **Zgjane, Lushnje** dhe banues në **Tiranë**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me **nr.028200154**, e cilit zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8 **Ekspertët kontabël**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9 **Pjesmarrja**

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10 **Ngritja e degëve apo filialeve**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11 **Ruajtja e Sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Tiranë, Njësia Administrative nr.5, Rruga "Bajram Curri" Hyrja nr.1, Zona Kadastrale nr.8260, Nr.Pasurisë 1/362-N6, volume 32, Faqe 180;
Email: info@gbthermocolor.al

NENI 13
Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GB THERMO- COLOR" SHPK

GËZIM SALLIU

